

There are no translations available.

“Duart larg nga e drejta jonë për grevë”

Hands off our right to strike

Qeveria dhe organizata e punëdhënësve i përgjigjen kërkesës së BSPSH: “Jemi pro grevës, e kemi dhe në Kushtetutë”

Fjala e Presidentit të BSPSH Gëzim Kalaja



“Praktika ka treguar se marrëdhëniet punëdhënës – punëmarrës në këtë 24 vjeçar ka patur oshilacionet e tyre, ka patur ulje dhe ngritje të marrëdhënieve mes dy palëve. Marrëdhënie të cilat janë shumë të rëndësishme për aktivitetin dhe zhvillimin e sindikalizmit, e cila çon pazgjidhshmërisht në realizmin e kërkesave të punëmarrësve, anëtarë ose jo të BSPSH. Asnjëherë, në asnjë kohë, historikisht që nga ngjarjet e Çikagos në vitet e largëta që

punëdhënësit të kenë interesa të njejta me punëmarrësin dhe anasjelltas. Në themelet e demokracisë për të cilën aspiroi dhe dha kontributin e vet BSPSH ishte që nëpërmjet kontratave kolektive, dialogut social dhe lirive të tjera sindikale të cilat kanë në brendësinë e tyre zhvillimin e protestës dhe grevës, realizmi i kërkesave ndaj punëmarrësve. Nëse tavolina e bisedimeve dështonte do të zgjidhej nëpërmjet grevës, apo negociimit që do të çonte pas grevës. Dhe përsëri nëse do të dështonte tavolina e bisedimeve do të kalohej në protesta dhe në greva. BSPSH në këto vite i ka qëndruar besnike respektimit të kërkesave të anëtarëve të saj nëpërmjet dialogut dhe në momentin që ka dështuar dialogu nëpërmjet protestës, që BSPSH –së nuk i ka munguar. Finalizimi i protestave të BSPSH datojnë në dy data; 16 maj 1991 dhe 22 nëntor 2014. Ka patur kontradita të vazhdueshme, mospërputhje të mendimeve dhe të filozofisë midis organizatës së punëmarrësve dhe punëdhënësve. **BSPSH-ja, si anëtare e Konfederatës Botërore ka marrë një letër në të cilën udhëzohet që sot me 18 shkurt 2015 të reagojë për të drejtën e zhvillimit të grevës. Sepse, Organizata Botërore e Punëdhënësve ka kërkuar që t'i hiqet e drejta e grevës dhe negociimit sindikatave kudo në botë. Kjo do të thotë, mosekzistenca e sindikatave.**

Dhe ka avancuar duke krijuar një lob në BE dhe PE që e mbështet këtë kërkesë të tyre. Shumëkush mundohet që sindikatën ta ngatërrojë me shoqërinë civile. këtë e bën dhe BE. Kjo nuk është pa qëllim. Mesazhi i Konfederatës Botërore është i qartë, ai po punohet sot në gjithë botën. Ne duhet të kundërshtojmë fuqishëm kërkesën e organizatës së punëdhënësve që t'i hiqet e drejta sindikatave për të bërë protestë, grevë dhe për të negociuar. Para se të komunikoj letrën e Sekretares së Përgjithshme të ITUC, Sekretarja e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në BSPSH Arjola Alike ka qenë në Bruksel në një takim, në një lobim të PE, kundër kërkesës së organizatës së punëdhënësve. Është krijuar një lobing nga deputetët e BE, në favor të konventave të ILO-s dhe ITUC, për të mos i hequr të drejtën e grevës sindikatave. Në Këshillin Kombëtar të Punës ne e trajtuam këtë problem ku ministri Veliaj u shpreh prerë se është për respektimin e të drejtave dhe lirive sindikale, dhe për të drejtën e zhvillimit të protestave dhe grevave. Në këtë mbledhje ne morëm dhe konfirmimin se Organizata e Punëdhënësve të Shqipërisë mbështet kërkesën e Konfederatës Botërore të Sindikatave”.

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të BSPSH, Presidenti Gëzim Kalaja i kërkoi anëtarëve votim për të mbështetur kërkesën e Konfederatës Botërore të Sindikatave e cila u miratuar pa asnjë votë kundër, apo abstenim. Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të BSPSH u diskutua në lidhje me kontratat kolektive dhe për probleme të tjera.





